



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0156

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare duke vendosur sipas ankesës së (OE) “AAG Projekt” kundër njoftimit për dhënie të një kontrate të aktiviteti të prokurimit të Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të ri të Gjinnazit Shkencor Bedri Pejani – RITENDER” me nr. të prokurimit: "635-23-10843-5-1-1", me 16/04/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “AAG Projekt” me nr. 2024/156 , kundër vendimit AK Komuna e Pejës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të ri të Gjinnazit Shkencor Bedri Pejani – RITENDER” me nr. të prokurimit: "635-23-10843-5-1-1".
2. Anulohet vendimi i Autoriteti Kontraktues”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të ri të Gjinnazit Shkencor Bedri Pejani – RITENDER” me nr. të prokurimit: "635-23-10843-5-1-1", dhe lënda kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarrë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 06.10.2023, Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i objektit të ri të Gjinnazit Shkencor Bedri Pejani – Ritender” me nr. të prokurimit: "635-23-10843-5-1-1". Ndërsa me datën 07.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate GOE “Dajting Sh.P.K.; N.N.P. Atc Com Sh.P.K”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës : 3,070,665.98 Euro.

Me 13.02.2024, “AAG Projekt” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 15.02.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 23.02.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “AAG Projekt” me nr. 32/2024 për lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i objektit të ri të Gjinnazit Shkencor Bedri Pejani – RITENDER” me nr. të prokurimit: "635-23-10843-5-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AAG Projekt” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Ankuesi pretendon: “Grupi i OE-ve ankues, me datën 13.02.2024, ka parashtruar kërkesë për ri shqyrtim të vendimit të AK-se, propozimit për dhënie të kontratës dhe ri rekomandimit për kontratë të grupit të OE-ve, të cilët Organi Shqyrtues i Prokurimit – Paneli Shqyrtues, me vendim i ka kualifikuar si të pa përgjegjshëm. Sipas vendimit të AK-se të datës 15.02.2024, është refuzuar kërkesa jone si e pa bazuar përkundër faktit se ne si OE, kemi prezantuar fakte dhe dëshmi konkrete ku vërtetohet se janë prezantuar dokumente fiktive në oferte. Autoriteti Kontraktues – Komuna Peje, fare nuk i trajton pretendimet dhe kërkesat tona madje të njëjtat i manipulon dhe inkriminohet në veprime penale, të sanksionuara me Kod Penal të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht shkele dispozitat e nenit 108/A, të LPP-se, paragrafin 8 pika 4. “autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi”. Autoriteti Kontraktues – Komuna Peje, zyrtaret përgjegjës të Prokurimit përfshirë edhe anëtarët e komisionit vlerësues të ofertave nuk i kanë shqyrtuar, pretendimet ankimore në kuptim të asaj që ne si OE kemi kërkuar.

Pretendimi i dytë (II): “Autoriteti Kontraktues - Komuna Peje, përkatësisht, Zyra e Prokurimit se bashku me anëtarët e komisionit ri-vlerësues të ofertave, përmes këtij publikimi përsëri kanë konsumuar shkelje ligjore të dispozitave të LPP-se nr. 04/L-042 të amendamentuar, madje kanë shkelur edhe vetë vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit me nr. 1032/23 të datës 23/01/2024, të nxjerre pikërisht për këtë procedurë të prokurimit. Bazuar në ankesën tone të dt. 19/12/2023, të parashtruar, paraprakisht në OSHP, eksperti shqyrtues me dt. 05/01/2024, ka nxjerre raport dhe pretendimet tona ankimore i ka kualifikuar si

te bazuara, madje ne te njëjtin raport është konstatuar se grupi i OE-ve te cilët AK, e ka ri rekomanduar për dhënie te kontratës, ka dorëzuar oferte te papërgjegjshme dhe atë lidhur me - stafin e kualifikuar - Menaxherin e Projektit, - Menaxherin e Punishtes, - Lidhur me deklaratat për krijim te grupit te njëjtëve OE, - Lidhur me stafin mbështetës, përkatësisht: - Certifikimet e tyre si dhe me - Pajisjet teknike te aplikuar për këtë procedure te prokurimit. Prove: Raporti e Ekspertes Shqyrtuese i datës 05.11.2024, me nr. 1032/2023. Përkundër këtij fakti, AK dhe Zyra përgjegjëse e prokurimit, është pajtuar se grupi i OE-ve, te cilët përsëri janë rekomanduar për dhënie, kane dorëzuar oferte te papërgjegjshme.

Pretendimi i tretë (III) : “Sipas qasjes se kërkuar dhe te ofruar ne dokumentacion, përkatësisht sipas përgjigjes se dhënë nga grupi i OE-ve ndaj kërkesës për sqarim ku AK – Komuna Peje është bazuar ne te njëjtat sqarime dhe ka ri rekomanduar për dhënie te kontratës grupin e OE-ve “Dajting & ATC Com” ShPK, rezulton qe jo për te gjitha te gjeturat e eksperti është kërkuar sqarim dhe plotësim. Ne si OE ankues edhe ne ankesën paraprake por edhe ne kërkesë për ri shqyrtim e kemi prezantuar bazën ligjore dhe faktet tjera se nuk është kërkuar sqarim shtesë për te gjitha pretendimet tona dhe te gjeturat ne ekspertize. - AK- Komuna Peje, ofertën e grupit te OE-ve te ri rekomanduar për dhënie te kontratës, detyrimisht ka qene dashur ta eliminoni si te papërgjegjshme, madje ta njoftoni organin shqyrtues te prokurimit, ne kuptim te nenit 99.2 te LPP-se dhe te kërkonte qe grupin e OE-ve te cilët përsëri është rekomanduar për dhënie te kontratës, te diskualifikohen nga procedurat e prokurimit, pasi që te njëjtit ne ofertën e tyre kane dorëzuar dokumente fiktive, mashtruese dhe te falsifikuara. Grupi i OE-ve ne ofertën e tyre kane prezantuar deklarata tatimore, kane prezantuar listën e stafit te ATK-se dhe ndaj te inxhinierëve potencohet se te njëjtit ne kompanitë përkatëse nuk janë te punësuar te rregullt. Dajting Shpk & ATC Com ShPK, si menaxher te projektit kane prezantuar z. Fisnik Syla - Ne oferte është prezantuar kontrata e datës 10.11.2015, e lidhur me punëdhënësin “Dajting” ShPK, me orar prej 40 orë ne jave, kurse ne Listën e Punëtoreve (ATK) ne emër te anëtarit “Dajting” ShPK , z. Sylaj, rezulton qe punën e ka sekondare tek OE “Dajting”shpk dhe jo si punëtor primare siç potencohet ne kontrate. Ngjashëm është vepruar edhe me menaxherin e punishtes ku është prezantuar z. Skender Loshi. Ne kontratën e lidhur me datën 03.01.2020, ne nenin 4, përcakton se orari i punës me punëdhënësin – anëtarin e grupit “ATC Com” ShPK është përcaktuar orari i punës prej 40 ore ne jave apo nga ora 08 deri ne 16. Sipas listës se Punëtoreve te ATK-se, te prezantuar ne oferte, z. Loshi, rezulton te ketë pune sekondare me anëtarin e grupit ATC Com ShPK. Pra edhe z. Loshi me punë primare është i deklaruar ne institucion tjetër ne cilësi te mësimdhënësit ne Shkolle te mesme dhe jo me anëtarin e grupit ATC Com ShPK, prandaj edhe kontrata e prezantuar ne oferte e lidhur me z. Loshin do duhej te konsiderohej si fiktive dhe jo reale dhe si e tille krijon alibi, meçe është e pa mundur qe një person te jete i kontraktuar me pune primare ne dy vende pune apo ne dy lokacione te ndryshme.

Pretendimi i katërt (IV) : “Ne përgjigjen e grupit te OE-ve te ri rekomanduar për dhënie te kontratës, përshkruhet dispozita ligjore e nenit 71.2 te LPP-se, lidhur me krijimin e grupit – konzorciumin, përderisa përmes kërkesës për sqarim AK – Komuna Peje, nga grupi i OE-ve te njëjtë, nuk ka kërkuar fare sqarim shtese lidhur me krijimin e grupit ku eksperti shqyrtues përmes raportit te ekspertizës, përkatësisht paneli shqyrtues përmes vendimit ka konstatuar se janë prezantuar deklarata për krijimin e grupit – konzorciumit ne mënyre te kundërligjshme, përkatësisht dy deklarata te ndryshme – variante dhe nuk dihet se cili nga dy anëtarët e grupit është lider. Ne njërën ane si lideri i grupit është caktuar OE “Dajting” ShPK, ne anën tjetër OE “ATC Com ShPK. - Deklarata e tille nuk i plotëson kushtet ligjore te nenit 71, te LPP-se dhe nenit 26, par. 1, pika a,b,c dhe d, te RRPP-se, nr. 001/2022 dhe AK, detyrimisht ka qene i obliguar ta eliminoi te njëjtën oferte si te pa përgjegjshme pasi qe: Neni 10 i Udhëzuesit nr. 001/2023, sqarimi i tenderit gjate procesit te vlerësimit sqaron rastet kur dhe si AK mund te kërkojë plotësim te

dokumentacionit: - Nëse mungon deklarata e qarte ku te gjithë e anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës, tenderi duhet te refuzohet pasi qe ky është kusht administrativ. Prove: deklarata. AK – Komuna Peje, zyra e Prokurimit, me rastin e plotësimit te te njëjtës deklarate përgjatë procesit te vlerësimit te ofertave ka shkelur dispozitat ligjore, siç është nenit 7 dhe 59.2 i LPP-së, përkatësisht nenit 10 te Udhëzuesit për Prokurim publik, pasi qe ka munguar deklarata e qarte e grupit dhe ka pranuar plotësim te dokumentacionit i cili nuk ka ekzistuar me rastin e ofertimit, përkatësisht oferta e grupit te ri rekomanduar për kontrate ka pësuar ndryshim material, ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-se. AK – Komuna Peje, fare mire është ne dijeni për deklarata te tilla ku është konstatuar gjendja reale dhe përmes procesit te rivlerësimit te ofertave por çuditërisht është anashkaluar ky fakt.”

Pretendimi i pestë (V) : “Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës, nuk kane prezantuar dëshmi lidhur me kërkesën tjetër kualifikuese, ku ne piken 4 te kërkesës 9.1 & 9.2, AK – Komuna Peje, ka kërkuar një person te certifikuar – diplomuar për kulme te rrafshëta. Sipas përgjigjes se dhënë nga grupi i OE-ve ndaj kërkesës për sqarim dhe te trajtuar si te mirëqenë nga AK, shihet qarte se OE-te e ri rekomanduar për dhënie te kontratës janë te papërgjegjshëm lidhur me certifikimin – diplomimin e personit për kulme te rrafshta ku tentohet përsëri te manipulohet me prova shkresore dhe nuk prezantohet kurrfarë dëshmie lidhur me certifikimin e tille dhe AK ne kundërshtim me nenin 59 dhe 72 te LPP-se pranoni dokumentacion shtese te paqene ne oferte dhe pranimi i dokumenteve te tilla pas hapjes se ofertave është i ndaluar sipas LPP-se dhe paraqet ndryshim material te ofertës.

Pretendimi i gjashtë (VI) : “Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës përkatësisht lideri i grupit OE “Dajting” ShPK, ne shkresa te lendes ka bashkangjitur referencën ne emër te inxhinierit te elektroteknikes z. Hysen Gashi, ku është lëshuar ne cilësi te punëve paraprake te realizuara por i njëjti nuk është i deklaruar si i punësuar tek OE “Dajting” ShPK, prandaj kjo reference do duhej te trajtohej si dokument fiktiv – jo real dhe do te duhej te eliminohej si oferte e pa përgjegjshme ligjërisht. Edhe pas ofrimit te sqarimit lidhur me këtë çështje nga grupi i OE-ve te ri rekomanduar për dhënie te kontratës, nuk ofrohet kurrfarë dëshmie se z. Hysen Gashi, është pjese e stafit te anëtarit te grupit, nuk është prezantuar kurrfarë kontrate apo dëshmi tjetër dhe si e tille do te duhej te eliminohej si e papërgjegjshme oferta e tyre bazuar ne kërkesat e përcaktuara ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontrate, përkatësisht sipas pikës 9.1 dhe 9.2, pozicioni 2.6, dhe dëshmisë dokumentare ndaj kësaj kërkesë, ku qarte është përcaktuar qe: OE duhet te prezantoje dëshmi kontrate valide; parakontrate noteriale me vërtetim – nënshkrim te noterit; diplome te noterizuar – certifikate te noterizuar (për inxhinirat qe kerkohet). Certifikata e prezantuar tani pas sqarimeve te ofruara nuk përmban noterizim e as nuk është prezantuar kontrate. Noterizimi i prezantuar ne vendimin e AK-se, kundrejt kërkesës sonë për ri shqyrtim është noterizim për tjetër dokument dhe jo për dokumente te kontestuar. Ngjashëm është vepruar edhe lidhur me inxhinierin z. Rahman Safedini, ku ne shkresa te lendes nuk është prezantuar ndonjë reference për pune paraprakisht te realizuara, rrjedhimisht nuk e plotëson kërkesën dhe dëshminë e përcaktuar tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ku ne piken 9.1 dhe 9.2 te FDT-se është kërkuar CV, reference, përkatësisht përvoja e punës sipas periudhës se përcaktuar. Edhe për z. Rahman Safedini, nga grupi i OE-ve te ri rekomanduar për dhënie te kontratës, ne përgjigje ndaj kërkesës për sqarim, vet përshkruhet kërkesa kualifikuese dhe dëshmia dokumentare ne njërën ane ku qarte ne dosje te tenderit është kërkuar “një pasqyre tabelare e punëtoreve dhe personelit, është kërkuar profesioni i kërkuar si dhe eksperiencia duhet te dorëzohet ne original, e nënshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik

Pretendimi i shtatë (VII): “AK – Komuna Peje, tendencën qëllimin e caktuar dhe shkeljen e parimeve baze te prokurimit publik e ka shpërfaqur për faktin se raporti i ri vlerësimit te ofertave përmban datën 25.01.2024, ndërsa kërkesa për sqarim te tenderit referuar grupit te OE- ve te ri rekomanduar për dhënie

te kontratës përmban datën 31.01.2024, përderisa përgjigja e dhënë nga OE te ri rekomanduar për dhënie te kontratës nuk përmban date fare. Ky fakt AK – Zyrën e Prokurimit se bashku me anëtarët e komisionit vlerësues te ofertave do duhej ta bene përgjegjës për abuzues me dispozita ligjore. Raporti i vlerësimit te ofertave bazuar ne nenin 16 paragrafi 2 te RRPP-se nr. 001/2022. Regjistri përmbledhës i prokurimit, parashef rrjedhën e procesit dhe veprimet te cilat duhet te ndërmerren nga AK përkatës, rrjedhimisht nuk mund qe fillimisht te nxjerrët raport rivlerësues, pastaj te kërkohet sqarim shtese. Përfundimisht, bazuar ne provat dhe faktet e prezantuara si me larte Grupi i OE-ve ankues, vlerëson se AK – Komuna Peje, edhe përgjatë ri vlerësimit te ofertave ka shkelur dispozitat ligjore, është inkriminuar ne vepra penale dhe nuk i ka raportuar, përkatësisht nuk i ka sqaruar dokumentet te cilat duket te jene fiktive dhe nuk është kërkuar konfirmim nga organi përmes te cilit supozohet se janë nxjerre te njëjtat certifikim.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “AAG Projekt” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 24, 25.8, 59, 69, 71, 105, 108/A, 131 të LPP-së si dhe neni 16, 40, 97 i Rregullorja nr. 001/2022, për Prokurim Publik si dhe neni 10 Udhëzuesi për Prokurim publik 001/2023. Kërkoj qe eksperti shqyrtues, bazuar ne dispozitat e nenit 113 dhe 114 te LPP-se, ti ndërmerr te gjitha veprimet ligjore te konfirmoi vërtitësin e dokumentacionit dhe t’i prezantoi te gjitha faktet dhe dëshmitë para panelit shqyrtues ne atë mënyrë qe OSHP te nxjerre këtë: Urdhëresë të Aprovohet si e bazuar ne tërësi ankesa, - Te Urdhërohet AK – Komuna Peje, qe te kthej lenden ne Rivlerësim, - Te shqiptohet GJOBE ndaj AK – Komuna Peje, ne kuptim te nenit 105, par 2.16, te LPP-së, për mos zbatim te vendimit me nr. 1032/2023.

-Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim-

“Përgjigja nga AK pretendimi 1: Ju njoftojmë se ne si A,K kemi vepruar konform LPP-se dhe mendimit te ekspertit shqyrtues te OSHP-se me nr. te ankesës 2023/1032 te datës 05.01.2024. ku ne si AK - KK Peje jemi pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues qe lënda te kthehet ne RI-vlerësim . Si dhe ne kemi respektuar vendimin e OSHP-se , sa i përket pretendimeve te juaja lidhur me Nenin 97 te Rregullore Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik nuk ka te beje fare me pretendimet e juaja ankimore pasi qe ne si A.K KK Peje , kemi vepruar konform vendimit te Ekspertit shqyrtues ku thuhet qarte qe lënda te kthehet ne RIVLERESIM, nuk ceket askund qe OE i propozuar për kontrate është i pa përgjegjshëm. Andaj te pika h)Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së nuk qëndron fare se ne si A.K KK Pejë kemi respektuar vendimin e panelit shqyrtues qe lënda te kthehet ne RI-Vlerësim andaj ju njoftojmë qe pretendimi juaj ankimor është i pa bazuar.

Përgjigja nga AK pretendimi 2: Ju njoftojmë se ne si A,K kemi vepruar konform LPP-se , si dhe pretendimet e juaja ankimore janë te pa bazuara pasi qe GOE i propozuar për kontrate kanë dorëzuar Deklaratat Nen Betim qe i qëndrojnë prapa çdo dokumenti te ofruar ne ofertën e tyre andaj është e pa arsyeshme qe te theksohet Neni 99. Pika 2 te LPP-se. ku O,E i qëndron mbrapa çdo dokumenti te oferuar. Dhe ne si A.K sqarimet e kërkuar për GOE , mendojmë qe janë te bazuara për komisionin vlerësues dhe për A.K, pasi qe ne edhe po e ruajmë Bugjetin e Republikës se Kosovës qe po e propozojmë një OE te përgjegjshëm me çmimin ne vlere prej: 2,555,752.00 €, ku oferta juaj është ne vlere preje 2,981,010.38 € dhe diferenca mese O.E te propozuar për kontratë dhe juve është 425.258.38 € dhe përgjegjësia jone ligjore është qe te ruajmë Bugjetin e Republikës se Kosovës. Andaj me këtë ju njoftojmë se pretendimet ankimore 2 janë te pa bazuara.

Përgjigja nga AK pretendimi 3: Ju njoftojmë se lidhur me Grupin e O.E për sqarimin e konzorciumit kemi kërkuar sqarime , para Rivlerësimit te A.P , ku me datën 05.12.2023 kemi dërguar Letër Standarde e

kërkesës për sqarimin e tenderit Ku mund të shihni edhe Letrën sqaruese që kemi dërguar O,E Dhe me datën 06.12.2023 kemi marr përgjigje nga O.E Dhe me poshtë mund të shihni letrën sqaruese të O.E lidhur me Grupin e konzorciumit Andaj ju njoftojmë se të pretendimi nr. 3 nga ana juaj nuk qëndron i bazuar pasi që ne si A.K kemi vepruar konform LPP-se dhe Rregullore Nr.001/2022 Për Prokurimin PUBLIK ku kemi kërkuar sqarime për këtë pikë andaj ju njoftojmë se pretendimi juaj është i pa bazuar.

Përgjigja nga AK pretendimi 4: Sa i përket pretendimit të juaj ankimore 4 ju njoftojmë se ne kemi vepruar konform mendimit të ekspertit shqyrtues ku kemi kërkuar sqarime lidhur me këtë certifikatë dhe ne si A.K kemi dërguar letër standarde për sqarime dhe sqarimet për AK kanë qene bindëse dhe konform D.T dhe NJ.K andaj ju njoftojmë se pretendimi juaj ankimore është i pa bazuar.

Përgjigja nga AK pretendimi 5: Sa i përket pretendimit të juaj ankimore 5 nuk qëndron pasi që ne D.T të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si ne vijim Kërkesa 2 Lista e stafit profesional. 2.1) Menaxheri i projektit - OE duhet të dëshmojë se ka një inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Konstruktiv, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit. 2.2) Menaxheri i punishtes - OE duhet të dëshmojë se ka një inxhinier të diplomuar ose master ,Drejtimi Konstruktiv, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit. 2.3) OE duhet të dëshmojë se ka një inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv. Kërkohet të ketë min 5 vite përvojë pune - angazhim profesional. 2.4) OE duhet të dëshmojë se ka një inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Mbrojtje e Mjedisit, të jetë i certifikuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit, , kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit. 2.5) OE duhet të dëshmojë se ka një inxhinier të diplomuar ose master Elektroteknikes, drejtimi Energjetike (jo bachelor), kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit. 2.6) OE duhet të dëshmojë se ka një inxhinier të diplomuar ose master Elektroteknikes, Drejtimi Elektronike. Kërkohet të ketë min. 5 vit përvojë pune –angazhime profesionale. 2.7) OE duhet të dëshmojë se ka një Inxhinier të Arkitekturës Kërkohet të ketë min 5 vite përvojë pune në fushën e projektimit. 2.8) OE duhet të dëshmojë se ka një inxhinier apo master të diplomuar të Makinerisë, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale. 2.9) OE duhet të dëshmojë se ka një inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Hidroteknikë, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit. 2.10) OE duhet të dëshmojë se ka një inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Gjeodezi, i licencuar me licence valide, kërkohet të ketë min. 3 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit. 2.11) Një (1) Inxhinier i Emergjencave - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit. Dhe si dëshmi kërkohet Dëshmia 2 Dëshmia për kërkesën -Stafin profesional. -Një pasqyrë tabelare të punëtorëve dhe personelit të kërkuar Emrin, mbiemrin, profesionin e kërkuar si dhe eksperiencën duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik. Për stafin e kërkuar prezentuar duhet të dorëzohen këto dokumente e dëshmi -Kontratë valide kopje për stafin i cili gjendet në listë të pagave se paku në 6 muajt e fundit. -Para kontratës noteriale me vërtetim nënshkrimi të noteri ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt, për stafin i cili nuk gjendet në listë të pagave se paku në 6 muajt e fundit. -Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit. -Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të punishtes. -Diploma e noterizuar. – certifikata e noterizuar (për ata inxhinier që kerkohen). Sqarim: AK mund të kërkojë për secilin dokument edhe dëshmi fizike. Aty ku thuhet përvoja e punës, gjithmonë përvoja llogaritet për vitet pas

diplomimit. Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës duhet diploma të jetë e nostifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës. Andaj Grupi i OE-ve është ne përputhje me kërkesat e D.T dhe NJ,K, Po ashtu ju keni cekur për certifikatën e Arben Murselit qe është fiktive duke na prezantuar web <https://www.wqrcert.com/sorgulama.php> Arben Murseli ne ofertën e dorëzuar nga A.K ka prezantuar certifikata te noterizuara e jo siç pretendoni ju qe nuk janë te noterizuara ku për me shume mund te shifni edhe foto deshmit: Sa i përket certifikatës për drenazhim te dheut me nr. 20022743 kemi hyre ne linkun <https://www.wqrcert.com/sorgulama.php> dhe kemi vendosur nr. 20022743 , dhe na është shfaqur ky dokument Ku shihte qarte Titulli : Arben Murseli , Id Cert: 20022743 Data e publikimit: 27.02.2020 Data e Leshimit te fundit : 27.02.2020 , Akreditimi: Akreditasyonsuz, Statuesi i Certifikates : Aktiv. Ne këtë web faqe qe keni prezantuar ne si A.K kemi hulumtuar dhe na është prezantuar ky raport , ku kjo nuk qëndron fare me atë qe keni prezantuar ju ne ankesën e juaj Ku dhe mund te bëni edhe ju krahasimin e kësaj certifikate , po ashtu edhe te certifikuar për trajtimin e mbetjeve (mbeturinave) te rrezikshme kemi hyr ne linkun <https://www.wqrcert.com/sorgulama.php> Ku dhe na është prezantuar si me poshtë Ndërsa ju ne ankesën e juaj keni prezantuar këtë dëshmi e cila nuk korrespondon me atë qe ju keni prezantuar ne pretendimet e juaja andaj pretendimet e juaja ankimore për këtë pike janë te pa bazuara.

Përgjigja nga AK pretendimi 6 : Ne përgjigje e dorëzuar nga Grup i OE ne sistemin e prokurimit është evidentuar data 06.02.2024 ne ora 12:42 sa i përket pretendimit te juaj për datën 31.01.2024 .E ka cekur Përgjigjeje e letrës standarde te datës 31.01.2024 kur ne kemi dorëzuar letrën për sqarim te ofertës me posht mund ti shihni dëshmitë. Pretendimi i juaj ne këtë pike është i pa bazuar.”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 28.02.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 156/2024, ndërsa me datë 11.03.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/156 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Nuk Pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa OE ka deklaruar se Pajtohet me mendimin e eksperteve

-Vlerësimi pretendimit ankimor të OE “AAG Projekt” - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/156 kanë vlerësuar si në vijim-

Konstatimi i parë (I): “Ekspertja shqyrtuese sqaron se, në rastin konkret, pretendimi lidhur me deklaratën dhe marrëveshjen e konzorciumit të cilat nuk përkojnë me njëra tjetrën, sipas vlerësimit të ekspertes, sqarimi i tyre paraqet ndryshim material, për faktin se është kusht administrativ, andaj sipas mendimit të ekspertes kjo pike e kualifikon OE të rekomanduar si të papërgjegjshëm. Konform nenit 59 par. 2 të LPP-së, citat: "2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve.

Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues" exp. nr. 1032/23: Në raportin e ekspertizës me nr.1032/23, kam rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim, si rrjedhojë AK është pajtuar plotësisht me rekomandimin, pa dhënë ndonjë koment shtesë, se nëse nuk pajtohet për ndonjë pikë brenda pretendimeve, konform rregullores për prokurim publik nr.001/2022 neni 67 par. 3 dhe 4, dhe nenit 115 të LPP-së, gjerësa AK kthen lëndën në rivlerësim, duke ri rekomanduar të njëjtin OE. RrPP nr. 001/2022 neni 67.3 dhe 67.4: "67.3 Nëse, në vendimin e tij, autoriteti kontraktues konstaton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme, dhe ankuesi nuk ka refuzuar, Autoriteti Kontraktues, brenda 5 ditëve ose kohës së lejuar nga eksperti, do të ndërmerret çfarëdo veprimi korigjues të rekomanduar nga eksperti. 67.4 Nëse, brenda afatit kohor të specifikuar, autoriteti kontraktues nuk e nxjerr vendimin që e refuzon ose e mohon vlefshmërinë e një pretendimi ose që nuk e vlerëson farë vlefshmërinë e një pretendimi, ankesa do t'i referohet panelit shqyrtues."

Konstatimi i dytë (II) : "Ekspertja shqyrtuese shpjegon se, në pretendimet ankimore ka dhënë përgjigje për secilin pretendim dhe mënyrën se si mund të trajtohen të njëjtat. Në ankesën 1032/23 disa pretendime kanë qenë të aprovuara si pjesërisht, duke sqaruar se si të njëjtat mund të sqarohen. Mirëpo, AK po që se sheh se operatori ekonomik nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht kushtin administrativ, atëherë nuk ka nevojë që të vazhdoj tutje të sqarohet, për faktin se, AK është pajtuar plotësisht me raportin, si e tillë operatori ekonomik veçse kualifikohet si i papërgjegjshëm."

Konstatimi i tretë (III) : "Ngjashëm është vepruar edhe me menaxherin e punishtes ku është prezantuar z. Skender Loshi. Ne kontratën e lidhur me datën 03.01.2020, ne nenin 4, përcaktom se orari i punës me punëdhënësin – anëtarin e grupit "ATC Com" shpk është përcaktuar orari i punës prej 40 ore ne jave apo nga ora 08 deri ne 16. Sipas listës se Punëtoreve te ATK-se, te prezantuar ne oferte, z. Loshi, rezulton te ketë pune sekondare me anëtarin e grupit ATC Com shpk. Pra edhe z. Loshi me punë primare është i deklaruar ne institucion tjetër ne cilësi te mësimdhënësit ne Shkollë te mesme dhe jo me anëtarin e grupit ATC Com shpk, prandaj edhe kontrata e prezantuar ne oferte e lidhur me z. Loshin do duhej te konsiderohej si fiktive dhe jo reale dhe si e tille krijon alibi, meçe është e pa mundur qe një person te jete i kontraktuar me pune primare ne dy vende pune apo ne dy lokacione te ndryshme" Ekspertja shqyrtuese lidhur me listat e pagave, kemi sqaruar se, punëtorët kyq në menaxhimin e aktivitetit të prokurimit, pra dy menaxherët përkatësisht i projektit dhe i punishtes në lista figurojnë me pune sekondare, kurse kontratat janë te lidhura me orar te plote 40 ore ne jave, pra kontratat e lidhura të punës nuk përkojnë me listën e pagave, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar."

Konstatimi i katërt (IV) : "Ekspertja shqyrtuese ka vlerësuar se sqarimi i deklaratave nën betim dhe marrëveshjes së konzorciumit paraqesin ndryshim material, për faktin se këto dokumente janë kusht administrativ dhe nuk mund të sqarohen apo te ndryshohen. Pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar."

Konstatimi i pestë (V) : "Sa i përket pretendimit lidhur me punëtorin e certifikuar për kulme të rrafshëta citat: "Madje sipas Agjencisë Shqiptare te Punësimit – ASHP, përkatësisht bazuar ne ueb faqen e tyre (<https://ashp.al/te-gjitha-kurset/>), rezulton qe i njëjti Agjencion fare nuk certifikon persona tille lidhur me hidroizolimet te ftohta dhe te ngrohta, përkatësisht kulme te rrafsheta. Rrjedhimisht, kjo certifikate është fiktive sipas ueb faqes dhe AK bazuar ne nenin 59 dhe 72 te LPP-se do duhej te kërkonte sqarim dhe ta eliminonte ofertën e tille." Ekspertja shqyrtuese pas analizimit në web faqe vëren se ky profesion nuk figuron, mirëpo ekspertja

vlerëson se nuk është e nevojshme që ti shkruaj kompanisë, lidhur me certifikatën për verifikim, për arsye se OE i rekomanduar nuk ka plotësuar kushtin administrativ.”

Konstatimi i gjashtë (VI) : “Ngjashëm është vepruar edhe lidhur me inxhinierin z. Rrahman Safedini, ku ne shkresa te lendes nuk është prezantuar ndonjë reference për pune paraprakisht te realizuara, rrjedhimisht nuk e plotëson kërkesën dhe dëshminë e përcaktuar tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ku ne piken 9.1 dhe 9.2 te FDT-se është kërkuar CV, reference, përkatësisht përvoja e punës sipas periudhës se përcaktuar” Ekspertja shqyrtuese sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduar nuk posedon dëshmi të eksperiencës, si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar. Tutje, pretendimi lidhur me certifikatën e punëtorit z. Arben Murseli, pretendimi nuk gjendet i bazuar, sepse sipas fakteve të prezantuara nga OE ankues, shohim se janë të pa akredituar, mirëpo AK në DT nuk ka specifikuar asgjë më shumë se të posedoj certifikatën. Kurse, sa i përket pretendimit lidhur me certifikatën për të cilën OE ankues pretendon se ka ndërhyrje, ekspertja shqyrtuese nuk ka vazhduar me verifikim, për faktin se OE i rekomanduar nuk ka plotësuar kushtin administrativ. Pretendimi tjetër i OE ankues citat: "Ne ofertën e grupit te OE- ve te rekomanduar për dhënie te kontratës. z. Arben Murseli, është prezantuar ne cilësi te drejtorit te anëtarit “ATC Com” ShPK, sipas certifikatës se ARBK-se, është nënshkruar deklarata nen Betim, ne emër te tije ne cilësi te Drejtorit te kompanisë, ndërsa tek lista e stafit mbështetës i njëjti është prezantuar ne cilësi te Personit te certifikuar për drenazhim te dheut dhe për trajtim te mbetjeve te rrezikshme inerte, është prezantuar si person i certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune ne cilësi te menaxherit, ndërsa sipas kontratës se datës 01.05.2021, se lidhur me vetveten rezulton qe z. Arben Murseli është i kontraktuar me OE “Atc Com” ShPK, me kualifikimet si: Ekonomist, gjeodet, person i certifikuar për armim, drenazhim, mbrojtje inerte dhe menaxher i punishtes." Ekspertja shqyrtuese sa i përket pretendimit, në raportin me nr. 1032/23 ka sqaruar se këto pozita mund të kërkohen të sqarohen me njësinë kërkuese, kurse AK në rivlerësim nuk ka dëshmi që është konsultuar më njësinë kërkuese, mirëpo sipas sqarimeve me lartë, konsideroj se nuk është e nevojshme për shkak se OE i rekomanduar nuk përmbushë kushtin administrativ.”

Konstatimi i shtatë (VII) : “AK – Komuna Peje, tendencën qëllimin e caktuar dhe shkeljen e parimeve baze te prokurimit publik e ka shpërfaqur për faktin se raporti i ri vlerësimit te ofertave përmban datën 25.01.2024, ndërsa kërkesa për sqarim te tenderit referuar grupit te OE- ve te ri rekomanduar për dhënie te kontratës përmban datën 31.01.2024, përderisa përgjigja e dhënë nga OE te ri rekomanduar për dhënie te kontratës nuk përmban date fare" Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe verifikimit te dokumenteve në e-prokurim sqaron se, raporti i rivlerësimit përmban datën 25.01.2024, në e-prokurim është e ngarkuar me datë 14.02.2024, kërkesa për sqarim nga AK përmban datën 31.01.2024, ndërsa përgjigja e OE të rekomanduar është publikuar me datë 06.02.2024. Si përfundim, sipas sqarimeve më lartë, ekspertja shqyrtuese vlerëson se, AK duhet ta kthej lëndën në rivlerësim, duke rekomanduar të njëjtën që procesin e rivlerësimit ta zhvilloj konform dispozitave ligjore të LPP-së, rregullores për prokurim publik nr. 001/2022 dhe udhëzuesit nr. 001/2023 për prokurim publik.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit, sipas të cilit ka rekomanduar Panelin që lënda të kthehet në Rivlersim.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin e OE- së ankues, se Autoriteti kontraktues ka shkelur vendimin e OSHP-së, është i pabazuar, për faktin se, Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit me nr. 1032/23 të datës 23/01/2024, i nxjerre nga Paneli shqyrtues, lidhur me aktivitetin e prokurimit sipas pikës 1 të vendimit, është vendim procedural/ Pajtim i palëve dhe jo merititor.

Lidhur me ankesën nr.1032/23 Paneli konstaton se ishte hartuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me 05.01.2024, sikurse kërkohet me nenin 113, dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform paragrafi 3 të nenit 115 të LPP, lidhur me nenin 20 të Rregullores së OSHP-së dhe se të dyja palët (AK dhe OE) janë deklaruar se formalisht se pajtohen me rekomandimin që lënda të kthehet në rivlersim. Por OE ankues pas rivlersimit të lëndës nga AK, nuk është pajtuar me vendimin e AK-se dhe ka paraqitur ankesën dytë në OSHP, më 23.02.2024, me nr. 32/2024.

Paneli shqyrtues pas vlesimit të provave të lëndës është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i objektit të ri të Gjymnazit Shkencor Bedri Pejani – RITENDER” me nr. të prokurimit: "635-23-10843-5-1-1". Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AAG Projekt” dhe se, argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i

bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin . Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AAG Projekt” janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues , ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i objektit të ri të Gjimnazit Shkencor Bedri Pejani – RITENDER” me nr. të prokurimit: "635-23-10843-5-1-1" , të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës , ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Ndërtimi i objektit të ri të Gjimnazit Shkencor Bedri Pejani – RITENDER” me nr. të prokurimit: "635-23-10843-5-1-1" të kthehet në rivlerësim si dhe AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe raportit të ekspertit shqyrtues.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në rivlerësim. Autoriteti kontraktues në bazë të nenit 59 të LPP-së mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, gjatë vendosjes, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuar në këtë nen.

Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, duke cituar: “Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lartë transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e

kryer të ofertës"

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - AAG PROJEKT**
- Arkivës së OSHP-së: